



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.8g.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMPANISË RAJONALE
UJËSJELLËSIT „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A. PRIZREN**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit „Hidroregjioni Jugor“ sh.a. Prizreni, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit *Senver Morina* dhe anëtari i ekipit *Ernes Beka*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
5 Qeverisja.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	30
Shtojca III: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjesit „Hidroregjioni Jugor” sh.a. për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13.09.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Kompanisë Rajonale të Ujësjesit „Hidroregjioni Jugor” sh.a.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Kompanisë Rajonale të Ujësjesit „Hidroregjioni Jugor” sha për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, përveç efekteve të përshkruara në paragrafin Baza për Opinion të kualifikuar, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Kryesuesi i Bordit nuk është pajtuar me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Kryesuesit të Bordit për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar, janë dhënë në detaje në Shtojcën III.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Kompanisë Rajonale të Ujësjetës „Hidroregjioni Jugor“ sh.a (Hidroregjioni Jugor ose Kompania). Ne kemi analizuar veprimtarinë Hidroregjionit Jugor se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i kualifikuar

Kemi audituar PFV-të e Hidroregjionit Jugor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për bazën për opinion të kualifikuar, pasqyrat financiare vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kualifikuar

Sipas SNK 16, kërkohet që njëherë në 3 deri 5 vite të bëhet rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese. Vlera e pasurive jo qarkulluese (toka, objekte ndërtimore, pajisje & makineri, vegla & inventar dhe mjete transportuese) sipas PFV ishte 17,880,383€ për të cilat Kompania nuk kishte bërë rivlerësimin e tyre që nga viti 2007. Andaj ne nuk ishin më gjendje që të konstatojmë nëse kjo vlerë është e saktë, apo e mbi/nënvlerësuar.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e PFV-ve'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë

relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të ndërmarrjeve publike në Kosovë, ZKA është e pavarur, dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Hidroregjionit Jugor për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një kompani private e auditimit, e cila kishte dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, për shkak të mos analizimit të vjetërsisë së të arkëtueshmeve dhe përcaktimit të vlerës reale të aseteve nëpërmjet procesit të rivlerësimit për kategorinë “Prona, Impiante dhe Pajisje”.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryesuesi i Bordit të Hidroregjionit Jugor është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq-deklarime materiale të shaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ndërmarrjes Publike Hidroregjioni Jugor.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime); dhe
- Kërkesat e Udhëzimit Administrativ nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore.

Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:

- Statuti i NP-së;
- Plani i Biznesit;
- Raporte tremujore;
- Raporte vjetore;
- Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në draft PFV-të ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në bilancin e gjendjes, në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me disa gabime materiale. Pas sugjerimeve tona për ti bërë veprimet e nevojshme, Hidroregjioni Jugor kishte bërë disa korrigjime, mirëpo nuk kishte arritur t'i eliminoj gabimet në tërësi.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, PFV-të e përgatitura nga KE dhe ZKFTH, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në BD, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në përjashtim të çështjes të përshkruara tek baza për opinion.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë si në vijim:

Në raportet e dy tremujoreve të parë të vitit 2017, Hidroregjioni Jugor nuk kishte arritur t'i përmbushë të gjitha kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen e raporteve tremujore siç e kërkon neni 31.1 i Ligjit të ndërmarrjeve publike. Hidroregjioni Jugor në këto raporte të tremujoreve kishte prezantuar vetëm tri nga pesë kërkesat e raportimit. Respektivisht nuk kishte prezantuar: 1) një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose që mund të përfshijnë NP-në ose që NP pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual; dhe 2) sugjerime dhe propozime për ndryshime të cila me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikim të opinionit të auditimit, dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet që kanë ndikuar opinionin të korrigojnë dhe të mos përsëriten.

Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, përfshirë edhe raportet tremujore. Nënshkrimi i pasqyrave nga ZKA dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen Bordit Drejtues.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Ndërmarrjen Publike. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Hidroregjionit Jugor, ishin relativisht të dobëta dhe ende kanë nevojë për përmirësime të mëtejme. Fushat kryesore ku nevojitet një qasje më e fokusuar për përmirësime janë: në planin e biznesit, në zvogëlimin e humbjeve teknike të ujit, në përmirësime të mëtejshme të kontrolleve rreth parandalimit të parregullsive, vlerësim i nevojave reale për blerje të mallrave me qëllim që të evitohen shmangiet nga procedurat e hapura të aktivitetit të prokurimit dhe shpenzimet jo racionale.

Po ashtu, mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurisë dhe mos rivlerësimi i tyre që nga viti 2007 rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo mund të ndikon në prezantimin jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.

Në këtë mënyrë kompania duhet të vendos ekuilibrat e duhur në mes të hyrave të planifikuara dhe shpenzimeve duke siguruar financim më të mirë dhe stabil dhe rezultate me vlerë për para.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga BD për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm në Kompani.

3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar komponentët financiar të të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit 2017-2019 (ku planifikimi përfundimtar nuk ka pësuar ndryshime nga ai fillestar) për kategoritë përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga shitja	4,478,618	4,478,618	4,171,108	4,159,372
Të hyrat nga shërbimet tjera	61,193	61,193	89,433	58,232
Të hyrat e shtyra (grantet)			1,164,930	577,297
Gjithsej të hyrat	4,539,811	4,539,811	5,425,470	4,794,901
Shpenzimet për paga	2,008,548	2,008,548	1,995,391	1,861,057
Shpenzimet operative	1,479,515	1,479,515	1,933,162	1,412,269
Shpenzimet e zhvlerësimit			1,254,423	1,255,668
Provizionet-Borxhet e këqija			212,000	473,300
Gjithsej Shpenzimet	3,488,063	3,488,063	5,394,976	5,002,294

Hidroregjioni Jugor, ndodhet në kushte ekonomiko financiare jo të favorshme për shkak të:

- Nivelit të ulët të faturimit të ujit prej 42% ndaj ujit të prodhuar (si rezultat i humbjeve të ujit) ka ndikim edhe në rritjen e shpenzimeve operative me theks të veçantë shpenzimet e rrymës elektrike që shfrytëzojnë pompat. Ato paraqesin 46% të totalit të shpenzimeve operative;
- Zvogëlimit të përgjithshëm të të hyrave prej 6% ndaj atyre të planifikuara (duke mos i llogaritur të hyrat e shtyra të donacioneve) dhe rritja e përgjithshme e shpenzimeve prej 12.6% ndaj atyre të planifikuara (duke mos i llogaritur shpenzimet e zhvlerësimit të vitit dhe borxheve të këqija);
- Realizimit të të hyrave të vitit 2017 krahasuar me të hyrat e vitit 2016 (duke mos i llogaritur të hyrat e shtyra të donacioneve) janë rritur për 1.2%, ndërsa shpenzimet e vitit 2017 krahasuar me ato të vitit 2016 (duke mos i llogaritur shpenzimet e zhvlerësimit dhe borxheve të këqija) janë rritur për 20%;
- Të hyrat e shtyra të këtij viti krahasuar me ato të vitit të kaluar janë të dyfishuara. Këto kanë ndikuar në rritjen e përgjithshme të të hyrave të këtij viti në vlerë prej 13%; dhe
- Shpenzimet e përgjithshme të vitit 2017, krahasuar me shpenzimet e përgjithshme të vitit të kaluar (përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit dhe provizionet) janë rritur në vlerë prej 8%.

Nga të dhënat e prezantuara më lartë, vërehet dinamika e rritjes së shpenzimeve të përgjithshme operative ndaj rritjes së të hyrave nga aktiviteti operativ.

Çështja 2 - Planifikimi/Realizimi i planit të biznesit i pa bazuar në mundësitë reale të kompanisë

- E gjetura** Ne e kemi trajtuar përmbajtjen e planit të biznesit. Ky plan përmban synimet afariste dhe financiare të cilat Kompania synon ti arrijë gjatë vitit 2017 si dhe qasjen për realizimin e tyre, por nuk përmbante afatet mujore për realizimin e tyre. Shpenzimet operative kishin një realizim 130% në raport me ato të planifikuara. Kompania me plan të biznesit nuk i kishte planifikuar: të hyrat e shtyra, shpenzimet e zhvlerësimit dhe të provizioneve të borxheve të këqija. Gjithashtu, kishte planifikuar një zvogëlim të humbjeve të ujit, përkundër kësaj humbjet kishin trend rritës nga viti paraprak.
- Përmbajtja e këtij plani në disa pjesë nuk reflekton mundësitë dhe nevojat reale të kompanisë. Kjo për shkak të funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme në përgatitjen e planit të biznesit.
- Rreziku** Mos hartimi i planit sipas mundësive reale të kompanisë rritë rrezikun që në fakt këto synime mos të realizohen në periudhën përkatëse apo në cilësinë e duhur.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e planit të biznesit duke u bazuar në mundësitë reale të kompanisë me qëllim të realizimit të synimeve afariste të sajë, dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestare të reflektohen në një plan të rishikuar.

3.2 Bilanci i gjendjes¹ (Pasqyra e pozitës financiare)

Ne kemi bërë auditimin e Bilancit të gjendjes, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

Tabela 2: Bilanci i gjendjes së Hidroregjioni Jugor më 31 dhjetor 2017 në €

Pasuritë	Viti 2017	Viti 2016	Detyrimet dhe Ekuiteti	Viti 2017	Viti 2016
Paraja në banke dhe arkë	436,467	109,431	Llogaritë e pagueshme tregtare	1,888,653	1,770,771
Stoqet	362,626	670,833	Obligime për tatime dhe kontribute	1,817,696	2,037,171
Llogarite e Arkëtueshme	2,999,526	2,938,713	Obligimet për hua	16,243	0
Pasuritë tjera financiare	3,139	0	Obligime ndaj të punësuarve (Sindikates)	8,186	8,186
Patenta, softueri dhe licenca	130,589	139,344	Obligim afat shkurt për avance	(4,060)	(3,625)
Toka	1,585,150	1,585,150	Detyrimet afatgjata-Të hyrat e shtyra	9,659,690	8,595,167
Objekte ndërtimore	2,236,964	2,434,966	Kapitali i themelues	25,000	25,000
Pajisje dhe makineri	13,775,750	12,661,854	Kapitali rezervë	14,974,725	14,974,725
Mjete transporti, vegla dhe inventar	151,929	132,574	Fitimi/humbja e bartur	-6,734,485	-6,527,092
			Fitimi/humbja e vitit	30,493	(207,393)
Gjithsej pasuritë	21,682,141	20,672,865	Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti	21,682,141	20,672,910

¹ SNK termin "Bilanc i Gjendjes" e kanë ndryshuar dhe emërtuar "Pasqyra e Pozitës Financiare", por derisa kompania e ka emërtuar bilanci i gjendjes edhe ne ju kemi referuar këtij emërtimi për të qenë konsistent me emërtimin e vet PFV-ve të cilat po i Auditojmë.

Çështja 3 – Mungesa e rregullores për menaxhim të pasurive

- E gjetura** Sipas nenit 7.2 të Statutit të kompanisë, Hidroregjioni Jugorë, duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë. Ne kemi vërejtur se kompania nuk kishte ndonjë rregullore për menaxhimin e pasurisë, e cila duhet të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e kompanisë duke u mbështetur në standardet dhe rregullat në fuqi. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit të rëndësisë së rregullores për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese.
- Rreziku** Mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurisë rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo mund të ndikon në prezantimin jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet që brenda një afatit sa më të shkurtër të hartoj një rregullore të brendshme mbi menaxhimin e pasurive jo qarkulluese, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për përdorimin e pasurive (të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit).

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Ndërmarrja publike Hidroregjioni Jugor në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017

Përshkrimi	Viti 2017	Viti 2016
Të hyrat nga shitja e shërbimeve	4,171,108	4,159,372
Të hyrat nga shërbimet tjera	89,433	58,232
Të hyrat e tjera afariste	1,164,930	577,297
Gjithsej të hyrave	5,425,470	4,794,901
Pagat mëditjet dhe kontributi pensional	1,995,391	1,861,057
Shpenzimet tjera afariste	1,933,162	1,412,269
Shpenzimet e zhvlerësimit	1,254,423	1,255,668
Provizionet për borxhet e këqija	212,000	473,300
Gjithsej shpenzimet	5,394,976	5,002,294
Fitimi/Humbja para tatimit	30,494	-207,393
Tatimi në fitim	0²	0
Fitimi/Humbja e pastër	30,494	-207,393

² Sipas Ligjit 05/L-29 për tatimin në të ardhurat e korporatave, neni 23 humbjet tatimore, Shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni, mund të bartet deri në gjashtë (6) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Bazuar në tabelën e mësipërme vërehet se kompania edhe përkundër një humbje të vitit të kaluar e cila ishte akumuluar nga vitet e mëparshme, vërehet se në vitin 2017 kishte operuar me fitime.

Çështja 4 - Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit

E gjetura

Ndërmarrjet Publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim që të respektojnë të gjitha procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Neni 16.3 i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) thekson se: Vlera e secilës kontratë duhet parashikuar dhe procedura e prokurimit përcaktohet konform vlerës. Autoriteti Kontraktues (AK) nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji "Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se një mijë (1.000€), por më e vogël se dhjetë mijë (10.000€) konsiderohen "kontrata me vlerë të vogël, si dhe Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është më e vogël se, ose me arsye pritet që të jetë më e vogël se një mijë (1.000€) konsiderohet si "Kontratë me vlerë minimale".

Nga pagesat e testuara ne kemi vërejtur se ndërmarrja kishte bërë blerje direkt nga operatorët ekonomik duke anashkaluar procedurat e prokurimit.

Arsyet sipas ndërmarrjes ishin, sepse ato ishin me vlera të vogla. Mirëpo në analizën tonë të bazës së shpenzimeve të ndërmarrjes kemi vërejtur se kishte disa blerje të mallrave ose shërbimeve me të njëjtën kompani ku shumica prej tyre ishin bërë me para të gatshme (petty cash) me vlera nën 100€. Vlera e përgjithshme e pagesave kalon kufirin e caktuar sipas LPP-së, prandaj AK ishte dashur të përdor njërin nga llojet e kontratave të nenit të lartcekur të LPP-ës. Këto blerje kanë ndodhur si rezultat i mungesës së funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme. Rastet e identifikuar po i paraqesim si në vijim:

- 64 pagesa me 4 (katër) operatorë ekonomikë të ndryshëm për Servisimin e automjeteve, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 4,885€;
- 17 pagesa për Furnizim me mjete shtëpiake, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,558€;
- 16 pagesa për Pjesë për defekte, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,583€;
- 26 pagesa për Kontrollim teknik, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 865€;
- 12 pagesa për Larjen e makinerisë, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 673€; dhe
- 19 pagesa për Furnizim me derivate vlera e përgjithshme e të cilave ishte 404€.

Mangësitë e identifikuar kishin ndodhur për shkak të mos funksionimit të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Blerja e mallrave dhe shërbimeve duke anashkaluar procedurat e prokurimit rrezikon që kompania të dëmtoj buxhetin duke mos arritur vlerën për paranë e shpenzuar dhe kufizim të konkurrencës.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur ndarjen e blerjeve të njëjta në disa sosh.

Çështja 5 - Humbje të mëdha të ujit të prodhuar dhe distribuuar

E gjetura Humbjet e ujit, në vitin 2017 ishin rreth 58% nga sasia e prodhuar dhe distribuuar e ujit. Gjatë vitit 2017 sasia totale e ujit të prodhuar dhe distribuuar ishte 17,482,425m³ nga kjo sasi ishin faturuar 7,366,856m³, ndërsa sasia prej 10,115,569m³ ishin humbje të ujit të distribuuar dhe të pa faturuar. Këto për shkaqe të rrjetit të vjetërsuar, të kyçjeve ilegale, orëmatësve të ujit jo funksional, dhe mungesës së kontrolleve të duhura për evitimin e defekteve dhe të keqpërdorimit.

Rreziku Humbjet e mëdha të sasive të ujit të distribuuar ndikojnë direkt në shpenzimet e prodhimit të ujit sidomos të shpenzimet e energjisë elektrike që e shfrytëzojnë pompat dhe kemikalet, rrjedhimisht ndikojnë edhe në humbjet/fitimet e kompanisë.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë konstatuar të gjithë shkaktaret e humbjeve të ujit dhe të marrë masat e duhura për zvogëlimin e tyre duke e përmirësuar raportin në mes të prodhim dhe faturimit, duke i zvogëluar humbjet dhe përmirësuar situatën financiare të kompanisë.

Çështja 6 - Llogaritja e tri pagave shpërblyese duke i përfshirë edhe shtesat tjera

- E gjetura** Sipas Marrëveshjes Kolektive të Kosovës e datës 18.03.2014 nenit 53, i punësuari, me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) pagave bruto sipas kontratës, në tre (3) muajt e fundit.
- Me rastin e pensionimit të katër punonjësve të Hidroregjioni Jugor tri pagat shpërblyese ua kanë llogaritur me të gjitha shtesat e tre muajve të fundit që i kanë marrë punëtorët duke i përfshirë shtesat e shujtave, shpërblimet etj. Këtu kemi mbivlerësimin e shpenzimeve për këto katër raste në vlerë 568€. Kjo për shkak të kontrolleve të dobëta në kalkulimin dhe menaxhimin e listës së pagave.
- Rreziku** Llogaritja e tri pagave të fundit me rastin e pensionimit duke i përfshirë shtesat e shujtave dhe shpërblimet tjera rrezikon që kompania të dëmtojë buxhetin e saj.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e pensionimit të punëtorëve, tri pagat duhet të iu paguhen sipas pagës bruto të kontratës për tre muajt e fundit pa përfshire shtesat tjera.

Çështja 7 - Angazhimi i punonjësve me kontratë për punë dhe detyra specifike pa procedura të rekrutimit

- E gjetura** Sipas Ligjit të punës 03L/212 neni 8 e obligon punëdhënësin për shpalljen e konkursit publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Hidroregjioni Jugor në 4 raste ka pranuar punëtor me kontratë për punë dhe detyra specifike (inkasant) pa zhvilluar procedura të rekrutimit për një kohëzgjatje prej 120 ditëve (4 mujore). Këta janë pranuar vetëm me një kërkesë, duke u shpërblyer me pagë fikse minimale të kompanisë prej 312€ për muaj.
- Kjo për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në procesin e krijimit të marrëdhënieve të punës.
- Rreziku** Mos zbatimi i procedurave të rekrutimit nuk siguron transparencë, konkurrencë dhe trajtim të barabartë me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës. Këto situata krijojnë papajtueshmëri ligjore dhe rrisin rrezikun që të punësuarit të mos jenë kompetent dhe të përgjegjshëm sikur të zgjidheshin përmes konkursit.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që kurdoherë dhe për çfarëdo pozita të përfill kërkesat ligjore për të ofruar konkurrencë dhe transparencë me qëllim të përzgjedhjes së punëtorëve adekuat që ofrojnë kualitet dhe performancë të mirë për punën dhe detyrat e kërkuara.

Çështja 8 - Dobësi në leximin e orëmatësve të ujit dhe faturimeve**E gjetura**

Faturimet për amvisëri, biznese dhe institucione publike bëhen sipas tarifores në fuqi e përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina (ZRRUM), ndërsa faturimi i paushallit bëhet në bazë të rregullores së ZRRUM R-03/UeK të datës 31 maj 2011, është 31.5m³/muaj. Këtyre faturimeve iu shtohet edhe TVSH prej 8%.

Nga mostrat e testuara kemi gjetur disa parregullsi, si rezultat i mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme, ato janë si në vijim:

- faturimi i një konsumatori ishte mbivlerësuar. Atij i ishin faturuar 23m³ ujë, ndërsa është dashur t'i faturohen 10m³ ujë.
- një konsumatori komercial edhe pse kishte orëmatës të ujit, i mungonte gjendja e tij paraprake se sa ka harxhuar ujë prej marsit 2016 e deri në korrik 2017, ku nga ky muaj i është ndërruar ujëmatësi dhe ka filluar faturimi prej 2m³/muaj.
- te një konsumator komercial, në bazë të kartelës identifikuese të gjendjes Inkasanti lokalit e gjen të mbyllur nga muaji nëntor 2016 deri në muajin gusht 2017 duke e faturuar me zero harxhim të ujit. Konsumatori në muajin gusht 2017 e kishte ndërruar orëmatësin e ujit, mirëpo inkasanti vetëm ka bërë leximin e orëmatësit të ujit, ndërsa është dashur që të lajmëroj ekipet tjera për bllobim dhe verifikim të orëmatësit të ujit, gjithashtu nuk kishte dëshmi se konsumatori ka bërë kërkesë për ndërrimin e orëmatësin të ujit.
- në mungesë të orëmatësit të ujit të konsumatorit, Inkasanti i ka faturuar me paushall prej gushtit 2014 e deri në qershor 2017 me vetëm 3 m³/muaj, ndërsa sipas rregullores është dashur të faturohet me 31.5 m³/muaj.
- në dy raste, inkasanti e ka faturuar (paushall) me zero pa e lexuar ujëmatësin prej 01.01.2016. Nuk ka asnjë dëshmi apo ndonjë vërejtje në lidhje me shërbimet përkatëse se këta konsumatorë nuk i shfrytëzojnë shërbimet e ujit.
- faturës me nr. 082-2017 për de-bllokim nuk është faturuar me TVSH prej 18% siç do të duhej, por me 8%, duke shkaktuar një nënvlerësim të kësaj fature për 246€.

Këto gabime kishin ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme.

Rreziku

Leximi jo i saktë i orëmatësve të ujit dhe faturimi me norme më të ulët të TVSH-ës krijon dëmtim financiar të kompanisë dhe po ashtu dëmton qytetarët.

Rekomandimi 8 Kryesuesi i Bordit duhet t'i shqyrtoj arsyet për gabimet e identifikuara si në leximin e orëmatësve të ujit ashtu edhe në procedimin e faturimeve dhe të marrë masa konkrete që gabimet e tilla të evitohen.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të kompanisë, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Kapitali i Hidroregjioni Jugor më 31.12.2017 në €

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
KAPITALI	8,295,734	8,265,240
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	14,974,725	14,974,725
Fitimet/Humbjet e bartura	-6,734,485	-6,527,092
Fitimet/Humbja e vitit aktual	30,493	-207,393

Rekomandimi

Në këtë fushë nuk kemi rekomandim.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve afariste, financiare dhe investimit. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme në €

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paratë neto nga aktivitetet operative	367,811	(162,045)
Rritja e parasë	428,194	469,358
Zvogëlimi i parasë	(60,383)	(631,402)
Paratë neto nga aktivitetet investive	(2,949,826)	(1,443,681)
Rritja e parasë	0	0
Zvogëlimi i parasë	(2,949,826)	(1,443,681)
Paratë neto nga aktivitetet financuese	2,909,051	1,712,900
Rritja e parasë	2,909,051	1,712,900
Zvogëlimi i parasë	0	0
Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit	327,036	107,174
Paraja në fillim të vitit	109,431	2,258
Paraja në fund të vitit	436,467	109,431

Çështja 9 - Mbajtja e parasë në bankë dhe mos fshirja e detyrimeve

E gjetura Siç shihet nga tabela e rrjedhës së parasë së gatshme, kompania e mbyll vitin me 436,467€ para të gatshme me të cilat mund të bëjë pagesa për ti zvogëluar obligimet e ndryshme që i ka. Nga bilanci i gjendjes shihet se kompania ka obligime të papaguara ndaj Operatorëve Ekonomik, për tatimeve dhe kontributeve, për huanë dhe ndaj sindikatës në vlerë të përbashkët 3,730,778€. Kompania nuk i kishte zvogëluar obligimet përderisa i kishte paratë në dispozicion për ti paguar një pjesë të tyre. Kjo për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme në menaxhimin e obligimeve.

Rreziku Mos pagimi obligimeve me kohë rrezikon kompaninë të ballafaqohet me obligime shtesë ndaj vonesave siç janë gjambat, interesat apo edhe mbulimin e shpenzimeve ndaj përmbaruesve privat.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që përderisa ka para të gatshme në dispozicion të bëjë pagesat e obligimeve për t'ju shmangur mundësive për ndëshkimeve dhe shpenzimeve shtesë.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja 10 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

E gjetura Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ose pasqyrën e rrjedhës së parasë, duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Gjatë analizimit të shënimeve shpjeguese janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- Nuk kishte shpalosur nëse ka raste gjyqësore në procedurë, të cilat mund ti shkaktojnë dalje të parasë nëse gjykata vendos në favor të palëve në konteste. Derisa kompania ka tri raste në procedure gjyqësore, dy prej tyre janë për konteste të marrëdhënies së punës dhe dëmshpërblimi nuk është i caktuar, ndërsa tjetra është padi për dëmshpërblim në vlerë 25,754€, e cila nuk ishte shpalosur; dhe
- Nuk kishte shpalosur nëse ka ngjarje pas datës së bilancit të gjendjes dhe nuk kishte shpalosur parimi e vijimësisë (nëse ka plane për të vazhduar me aktivitet biznesor edhe vitet tjera).

Këto kanë ndodhur shkak i mungesës së konsultimit të SNK-ve dhe funksionimit të sistemit të kontroleve të brendshme për identifikimin e gabimeve me kohë për korrigjimet e nevojshme.

Rreziku Prezantimi jo i plotë dhe mangësitë e informacioneve në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare si dhe kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të rezultateve financiare dhe afariste të kompanisë.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve janë prezantuar në shënimet shpjeguese të gjitha informacionet për secilin zë të pasqyrave financiare që ka nevojë të shpaloset, dhe informacionet tjera që kërkohen të prezantohen në PVF.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit të jashtëm për PFV-të e vitit 2015 dhe 2016 të Hidroregjionit Jugor ishte kryer nga një kompani private e auditimit e cila kishte dhënë opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes dhe ka rezultuar me 2 (dy) rekomandime të njëjta për dy vitet. Hidroregjioni Jugor nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Këto dy rekomandime kishin të bënin me përcaktimin e vlerës reale të aseteve përmes procesit të rivlerësimit dhe mos analizimi i vjetërsisë së të arkëtueshmeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, njëri rekomandim ishte në proces të zbatimit, ndërsa tjetri nuk ishte zbatuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 11 - Zbatim i ulët i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, që të dy rekomandimet e vitit paraprak dhe dy të bartura nga viti i më hershëm nuk kanë arritur të zbatohen plotësisht deri tani, por megjithatë njëri rekomandim ishte në proces të zbatimit. Rekomandimet kanë të bëjnë me përcaktimin e vlerës reale të pasurive përmes procesit të rivlerësimit për kategorinë “Prona, Impiante dhe Pajisje” i cili është në proces të adresimit nga ndërmarrja në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE-në), dhe rekomandimi tjetër kishte të bënte me “Analizimin e Vjetërsisë të arkëtueshmeve” që priten vazhdimisht veprime edhe në të ardhmen si shkak i ligjit mbi faljen e borxheve.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake rrit rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me PFV dhe me kontrollet e brendshme.
- Rekomandimi 11** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është përgatitur plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili i përcakton veprimet, afatet kohore dhe stafin përgjegjës dhe azhurnohet në çdo tre muaj për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve.

5 Qeverisja

Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja, në Hidroregjionin Jugor vështuar në kuptimin e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe planifikimit strategjik, pasqyrojnë një situatë pozitive. Kompania ka zbatuar rekomandimet e auditorit të brendshëm. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre aty ku kishte identifikuar mangësi. Megjithatë kompania kishte nevojë në forcimin e kontrolleve në menaxhimin e rreziqeve operative dhe përgatitjen e një plani për identifikimin dhe mënyrën e menaxhimit të rreziqeve potenciale.

Hidroregjioni Jugor bënë përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm të vitit të kaluar, forcimit të kontrolleve të brendshme dhe operimit efektiv të sistemit të auditimit të brendshëm sipas standardeve të kërkuara.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të ndërmarrjes Hidroregjioni Jugorë dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komision i Auditimit efektiv.

NJAB kishte përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2017. Hartimi i planit ishte përgatitur bazuar në nivelin e rrezikut për sistemet dhe proceset e përfshira në auditim siç janë: të hyrat, shpenzimet, prokurimin, procesin e faturimit dhe inkasimit, etj. Kishte 13 auditime të planifikuara dhe të përfunduara për vitin 2017, si dhe 4 auditime me kërkesë të Komisionit të Auditimit (Realizimi i kontratës "Rehabilitimi i sistemit të ujësjellësve në zona rurale", Menaxhimi i procesit të shpenzimeve në Suharekë dhe Malishevë, Menaxhimi i procesit të shpenzimit të pagave dhe Procedurat e prokurimit rreth realizimit të projekteve investive).

Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqe dhe në vlerësimin e kontrolleve të brendshme të kompanisë. Përmes raporteve, NJAB i kishte ofruar informata menaxhmentit se sa efektive janë kontrollat e brendshme dhe funksionimi i tyre. Komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar të gjitha rekomandimet e NJAB.

Ne vlerësojmë punën e bërë nga kjo njësi dhe raportet ishin cilësore dhe të dëshmuara në mënyrë adekuate, ku kishin mbuluar aktivitete në proces, duke arritur të identifikojnë disa nga mangësitë në sistemet e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Menaxhmenti pas këshillave tona në fazën e ndërmjetme kishte bërë planet e veprimit për zbatimin e të gjeturave të NJAB-së.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet e kontrolleve të brendshme funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të mangëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 12 - Kontrollë të pa mjaftueshme rreth menaxhimit të rreziqeve

- E gjetura** Disa nga objektivat e synuara të kompanisë nuk ishin arritur, si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, siç ishin: anashkalimi i procedurave të prokurimit rreth blerjes së mallrave dhe shërbimeve, ndarja e faturave, nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit, të cilat rrezikojnë që kompania të dëmtojë buxhetin dhe të mos arrijë vlerën për parane të shpenzuar si dhe kufizim të konkurrencës. Gjithashtu humbjet e larta të ujit, leximi i orëmatësve të ujit dhe faturimet me normë jo adekuate të TVSH-ës nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit, këto ndikojnë direkt në të hyrat e kompanisë dhe rrjedhimisht në fitimet e saj. Këto kanë ndodhur shkaku i llogaridhënies dhe kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme.
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimit e reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me rritjen e rrezikut për shpenzime të parregullta dhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.
- Rekomandimi 12** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë masat e nevojshme për identifikimin e mangësive menaxheriale dhe rreziqet potenciale operative dhe financiare të kompanisë. Po ashtu, të hartojë planin e rreziqeve të mundshme, të vlerësojë ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktojë masat parandaluese dhe ato vepruese si përgjigje ndaj tyre.

Çështja 13 - Disa nga faturat e pranuaratë pa protokolluara

- E gjetura** Është praktike e mirë në kontrollet e brendshme që faturat e pranuaratë protokollohen, për të menaxhuar me mirë duke e matur kohën e pranimit deri në pagesën e saj për t'ju shmangur vonesave në afatin e përcaktuar për pagesë. Në kemi vërejtur kontroll të dobëta në menaxhimin e faturave, nga 68 pagesat e testuara për mallra dhe shërbime, Kompania në 57 raste nuk e kishte bërë protokollimin e faturave të pranuaratë. Pas këshillave të dhëna në fazën e ndërmjetme të auditimit Kompania kishte filluar protokollimin e faturave, mirëpo faturat e pranuaratë nga njësitë rajonale ende (deri në prill 2018) nuk kishin filluar protokollimin. Kjo për shkak të kontrolleve të pa mjaftueshme në procesin e pranimit të faturave.
- Rreziku** Mos protokollimi i faturave rrit rrezikun që kompania të dëmtojë buxhetin duke bërë pagesa për fatura fiktive, apo duke u vonuar përtej afatit të përcaktuar për pagesë. Këto kanë ndikime direkte edhe në cilësinë e pagesave ndaj furnitorëve dhe ndikojnë në reputacionin e Kompanisë.
- Rekomandimi 13** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se me rastin e pranimit të faturave, kompania i protokollon secilën prej tyre para se ato të dërgohen për pagesë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare. 158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;

- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Prona, Impiantet dhe Pajisjet	Të bëhet testimi i demit të aseteve në baza vjetore në mënyre që të përcaktohet vlera e rikuperueshme e aseteve, ose të angazhohen vlerësues të pavarur dhe profesional të cilët do të përcaktojnë vlerën reale të aseteve.			Nuk është zbatuar.
Analiza e vjetërsisë së arkëtueshmeve	Që të kemi kontrole me të mirë të kërkesave, neve rekomandojmë Kompanisë të bëjë analiza të rregullta të vjetërsisë. Kjo do ti ndihmoi menaxhmentit të përmirësoi arkëtimet dhe barazimet me konsumator. Për me shumë analiza e vjetërsisë do ti ndihmoi Kompanisë të ketë histori me të mirë dhe të bëjë vlerësime me të sakta për provizione të borxheve të këqija.		Janë në përpjekje të adresimit të këtij rekomandimi, duke bërë faljen e borxheve sipas ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike (me plotësim ndryshime) për konsumatorëve që kanë borxhe të vjetra, dhe njohjen e borxheve të këqija, gjegjësisht inkasimin nëpërmjet procesit të përmbarimit.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Prona, Impiantet dhe Pajisjet	Të bëhet testimi i demit të aseteve në baza vjetore në mënyre që të përcaktohet vlera e rikuperueshme e aseteve, ose të angazhohen vlerësues të pavarur dhe profesional të cilët do të përcaktojnë vlerën reale të aseteve.			Nuk është zbatuar.

Analiza e vjetërsisë së arkëtueshmeve	Që të kemi kontrole me të mirë të kërkesave, neve rekomandojmë Kompanisë të bëjë analiza të rregullta ta vjetërsisë. Kjo do ti ndihmoi menaxhmentit të përmirësoi arkëtimet dhe barazimet me konsumator. Për me shumë analiza e vjetërsisë do ti ndihmoi Kompanisë të ketë histori me të mirë dhe të bëjë vlerësime me të sakta për provizione të borxheve të këqija.		Janë në përpjekje të adresimit të këtij rekomandimi, duke bërë faljen e borxheve sipas ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike (me plotësim ndryshime) për konsumatorëve që kanë borxhe të vjetra, dhe njohjen e borxheve të këqija, gjegjësisht inkasimin nëpërmjet procesit të përmbarimit.	
---------------------------------------	---	--	---	--

Shtojca III: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
<p>Baza për opinion të kualifikuar</p> <p>Sipas SNK 16, kërkohet që njëherë në 3 deri 5 vite të bëhet rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese. Vlera e pasurive jo qarkulluese (toka, objekte ndërtimore, pajisje & makineri, vegla & inventar dhe mjete transportuese) sipas PFV ishte 17,880,383€ për të cilat Kompania nuk kishte bërë rivlerësimin e tyre që nga viti 2007. Andaj ne nuk ishin më gjendje që të konstatojmë nëse kjo vlerë është e saktë, apo e mbi/nënvlerësuar.</p>	<p>Jo</p>	<p>Sa i përket çështjes së vlerësimit dhe të rivlerësimit të pasurisë, KRU "Hidroregjioni Jugor" Prizren, si kompani publike, në vazhdimësi ka bërë përpjekje që të bëjë rivlerësimin e aseteve. Ekzistojnë procesverbalet me shkrim gjatë takimeve të mbajtura me Bordet e Drejtorëve, e sidomos në Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin, mirëpo që deri më tani, sikurse edhe është përshkruar në vijim të komentit, një gjë e tillë nuk është realizuar nga Aksionari – gjegjësisht pronari i aseteve e që është Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE).</p> <p>Poashtu, kemi bërë kërkesë me shkrim dhe i kemi dërguar të njëjtën Aksionarit në mënyrë që të na lejoj të formojmë një komision nga kompania, respektivisht të angazhoj vlerësues të pavarur dhe profesional për përcaktimin e vlerës reale të Aseteve. Por, deri më tani jemi në pritje të një përgjigje nga Aksionari.</p> <p>Lidhur me këtë kemi edhe rekomandimet tuaja, që kanë të bëjnë me përcaktimin e vlerës reale të pasurive, përmes procesit të rivlerësimit për kategorinë prona impiante dhe pajisje, që do të thotë se i njëjti është në proces të adresimit nga ndërmarrja në bashkëpunim me MZHE-në (vlerësimi juaj-auditor, Por, përkundër kësaj kjo e njëjta ka ndikuar në opinionin tuaj për vlerësim të paraqitur si Çështja 11).</p> <p>Përkundër kësaj KRU "Hidroregjioni Jugor" Prizren, ka formuar një komision të brendshëm, i cili do të bënte vlerësimin e Aseteve (vendimi nr. protokollit 2230, të datës 14.11.2017) Komisioni ka filluar punën. Komisioni me datën 22.02.2018 dhe nr. protokollit 300/1, ka dorëzuar një Raport dhe listë të aseteve të cilat vlerën në librat kontabël e kanë zero, dhe se të njëjtat ende janë në përdorim, e që këto janë kryesisht</p>	<p>Me gjithë përpjekjet e bëra nga Kompania për të bërë rivlerësimin e pasurive jo qarkulluese, dhe nga premtimet e aksionarit për mbështetjen në këtë çështje, ende nuk kishte arritur që të bëjë rivlerësimin e tyre. Pra pasuritë janë të pa rivlerësuar që nga vitit 2007. Kompania edhe me komentimin e saj e pohon një gjë të tillë. Andaj gjendja e konstatuar nga Auditori për mos rivlerësim të pasurive qëndron.</p>

		<p>pajisje të zyrës dhe pajisje të IT-së. Në të ardhmen komisioni do të vazhdoi punën lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e kategorive të tjera të aseteve siç janë rrjeti i ujit, rrjeti i kanalizimit e tjera në mënyrë që gjendja e këtyre Aseteve të paraqitet në libra kontabël sa më reale.</p> <p>(shih të bashkangjitur - te skenuara)</p> <ol style="list-style-type: none">1. procesverbalin e takimit të B.D në takimit Vjetor me Aksionarin, të datës 13.06.2017, faqe 2).2. Kërkesën për vlerësim të aseteve drejtuar NJPMNP - MZHE-se datë 12.02.2018, si dhe3. Vendimi për formimin e komisionit, si dhe raportin e komisionit të rivlerësimit, të realizuar nga kompania jonë.	
--	--	---	--